



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–  
01.Nr. zyrtar/ 2023

### Procesverbal

Takimi i VI-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023

Më 14.12.2024

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi**, Kryetar i Komunës

**Jaser Jaha**, Stacioni i Policisë-Kaçanik

**Fatmir Qaka**, EVSB

**Bujar Bajra**-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

**Naim Hysa**-Kryqi i Kuq Komunal

**Jashar Selimi**-Këshilli i Prindërve

**Menduh Krasniqi**-Inspektorati Komunal

**Ekrem Livoreka**-Komitetit për Komunitete

**Shemsedin Abazi**-KLSP

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Përgatitja me përballjes me sfidat në sezonin e dimrit
- 4.Aprovimi i Planit të Punës së KKSBB për vitin 2024
- 5.Të ndryshme

1.Procesverbali u miratua nga të pranishmit

## **2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut**

Në pikën e dytë të rendit të ditës për periudhën në mes dy takimeve Kryetari fjalën ia dha zv.Komandantit të Policisë z. Jaser Jaha.

**Jaser Jaha** – Gjendja e sigurisë në Komunën tonë në periudhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë.

Në kuadër të stacionit të Policisë ne kemi disa plane operative e ndër ta është edhe targeti i

parandalimit të vjedhjeve , mandej kemi planin e ngritjes së nivelit të sigurisë në nivel vendi e gjithashtu jemi duke e përpiluar një plan për ngritjen e nivelit të sigurisë përfundëvit dhe për vitin 2024 .

Po i përmendi disa raste qe ne jemi marrë në këtë periudhë kohore e që nga ne konsiderohen si vepra jo ligjore ; kemi pasë një rast të armëmbajtjes pa leje ,7 vjedhje , dy raste të dhunës në familje, lëndime trupore tri raste , kanosje dy raste dhe 5 aksidente me dëmtime materiale .

**Jashar Selimi** – Një shqetësim që dua ta paraqes është në lidhje me një person që është me të meta mendore i cili po pengon komunikacionin sidomos në rrugën regionale. Më intereson të dijë se a jeni marrë me këtë rast .

**Jaser Jaha** – Vërtetë që është një shqetësim madhë por që nuk është vetëm ky rast por ka edhe disa persona tjerë me sëmundje mendore që shpeshherë po ndodhë që po na lajmrohen qytetarët për sjelljet e tyre në rrugë .

E vjetmja gjë që ne mundë të bëjmë është që këto raste të i përcjellim në entin social e ata të i drejtojnë në ndonjë institut adekuat për trajtim .

Ka edhe raste kur kemi bërë zgjidhje për dërgimin e tyre për trajtim në institute përkatëse por që familjarët nuk kanë pranuar .

### **3.Përgatitja me përballjes me sfidat në sezonin e dimrit**

**Kryetari** – Ne si Komunë i kemi bërë përgatitjet për përballje me sfidat që mundë të i kemi gjatë këtij sezoni dimërorë .

Deri më 31 dhjetor të këtij viti ne kemi të kontraktuar kompaninë për mirëmbajtje të rrugëve dhe kemi hapur ofertë për kompanitë që mirren me mirëmbajtje të rrugëve .

Komisioni Komunal ka bërë përzgjedhjen e kompanisë dhe besojë që nëse nuk kemi ndonjë ankesë ne do ta kemi kompaninë që do të operoj me kohë në mirëmbajtjen e rrugëve .

**Ekrem Livoreka** – Dua të ngrisë një shqetësim të banorëve të Lagjes Kodrali në Ivangjë të cilët gjatë reshjeve të mëdha të borës po bllokohen si lagje dhe nuk po u ofrohet shërbim nga Kompania.

**Kryetari** – Plani i Kompanisë është që të i lirojë rrugët që janë me prioritetë duke i përfshi rrugët locale që lidhen me qytet për të ju krijuar qytetarëve shërbime të ndryshme që kanë nevojë ata.

Nëse këto rrugë lirohen atëher kompania i ka në konsideratë edhe rrugët tjera të cilat janë të bllokuara . Mundësitet bugjetore të Komunës janë të vogla për të rritur shërbimet për të gjithë në situata të jashtëzakonshme .

Është për keqardhje ndihma e nivelit qendërorë të cilët tash e tri vite nuk na kanë përkrahur me projekte që ndikojnë në mirëqenjen e qytetarëve .

### **4.Aprovimi i Planit të Punës së KKSBB për vitin 2024**

**Kryetari** – Lidhur me planin e punës së KKSBB-së për vitin 2024 fjalën ia kisha dhanë Fatmirit i cili është marrë më shumë me të.

**Fatmir Qaka** – Sa i përket planit të punës së KKSBB-së për vitin 2024 siq jeni njoftuar me kohë, na ka ardhë një model plan nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe këtë model plan ia kam përshtatur me specifikat e Komunës tonë dhe paraprakisht ua kam përcjell grupit punues për hartimin e këtij plani për ndonjë plotësim por që deri më sot nuk kam pranuar ndonjë koment.

Unë e kamë përcjellë këtë planë edhe tek të gjithë akterët e KKSBB-së dhe nëse pajtoheni që ky plan të aprovohet atëher duhet të fillojmë procedurat për ta dërguar në Kuvendë ngase në bazë të këtij plani mbledhja e parë e KKSBB-së për vitin 2024 është planifikuar të mbahet në fundë të muajit shkurt 2024 dhe që duhet në seancën e parë të Kuvendit Komunal në muajin janar 2024 të del për miratim . Temat e paraqitura janë të natyrave të ndryshme që janë diskutuar edhe në të kaluarën me disaaktivitete shtesë.

Pas disa sqarimeve u vendosë që ky plan kështu siq është të përcillet për në kuvnd për miratim.

## 5.Të ndryshme

**Menduh Krasniqi** – Raportet e bashkëpunimit me Policinë e Kosovës i kemi shumë të mira por që në disa raste informatat për ndonjë aksident po na vijnë të mangëta dhe po na e vështirësojnë punën tonë si inspektoriat .

Kisha dashur që informatat të na vijnë të kompletuara me qëllim të lehtësimit të punës tonë gjatë ndjekjes së procedurave të mëtutjeshme .

Një ankesë tjetër na ka ardhë rreth parkingjeve ilegale në rrugën „Jehona Raka” ku kjo rrugë është e ngushtë dhe është e pamundur qarkullimi dy kahësh .

Qytetarët thonë që e kemi paraqitë këtë rast në Polici por që gjendja nuk ka ndryshuar .

**Jaser Jaha** – Patrollat e Policisë kanë dalë dy tre herë dhe në bazë të raporteve ata qytetarë e kanë problemin në mes vete.

Në bazë të tri raporteve që kemi marrë në këtë hapësirë nuk pengohet qarkullimi i lirë i këmbësorëve .

**Menduh Krasniqi** – Një tjetër qështje që dua të ngrisë lidhur me parkingun te QKMF i cili po keqëpërdoret nga persona të pandërgjegjshëm por edhe nga bizneset .

Një pjesë e parkingjeve janë të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara dhe një pjesë për pacient që kanë nevojë për tretman mjekësor.

**Jaser Jaha** – Sa i përket kësaj qështje që u ngritë është problematike për zyrtarët Policorë që të kontrolloj këtë keqëpërdorim të parkingut të automjeteve në kët hapësirë .

**Kryetari** – Për të penguar kët keqpërdorim atëher duhet që ky parking të bëhet me pagesë .

**Naim Hysa** – Mendoj që pos dy parkingjeve që janë për personat me aftësi të kufizuara të janë pa pagesë kurse pjesa tjetër të shfrytëzohet me pagesë .

### **Rekomandimet**

- 1.Të mirret seriozisht qështja e personave me të meta mendore që lëvizin rrugëve e që shpeshëherë po krijojnë probleme të natyrave të ndryshme, të trajtohen në institucionë adekuate .
- 2.Të mirren masa ndaj atyre që pengojnë qarkullimin e lirë të qytetarëve nëpër trotuarë.
- 3.Të ju ipen përparësi rrugëve me prioritet gjatë sfidave që mundë të ballafaqohemi gjatë sezonit dimërorë .
- 4.Të mirren masa ndaj atyre që keqëpërdorin parkingjet falas në hapësirën pran QKMF .

Kryesoi: Kryetari - z. Besim Ilazi



Procesëmbajtës: Fatmir Qaka